REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA · REPUBLIC OF KOSOVA
QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVËS · QENDAR ZA KINEMATOGRAFIJU KOSOVA
KOSOVA CINEMATOGRAPHY CENTER
Ref. Nr. 377/2014
Data 16.07.2014
Datum
Date
Nënshkrimi
Potpis
Signature
PRISHTINË

RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
TELEVIZIONI
Nr. 2171/14
Data 16-07-2014
PRISHTINË

QENDRA KINEMATOGRAFIKE E KOSOVES

dhe

RADIO-TELEVIZIONI I KOSOVËS

Qendra Kinematografike e Kosovës
QKK

dhe

Radio Televizioni i Kosovës
RTK

Në emër të interesit publik, për zhvillimin e kinematografisë, industrisë së filmit dhe industrisë televizive në Kosovë dhe duke u mbështetur ne Nenin 7 Paragrafi 1 pika 22 dhe pika 23 e Ligjit për RTK-në, lidhin këtë:

MARRËVESHJE

Objekt i kësaj Marrëveshje është bashkëpunimi në në lëmin e prodhimit të filmit.

QKK dhe RTK pajtohen që të bashkëfinancojnë projektet filmike me kushtet dhe kërkesat si vijon:

Neni 1

Në bazë të planit vjetor dhe mundësive që ka, RTK merr përsipër që të financoj prodhimin e veprave filmike në lartësi prej jo më pak se 30 % të buxhetit të saj të planifikuar për mbështetjen/blerjen e veprave Audio –Vizuale.

Neni 2

RTK do të zbatoj Nenin 1 të kësaj Marrëveshje, përveç në rastet e mungesës së mjeteve financiare të dedikuara për blerjen e veprave Audio-Vizuale apo ndalesave tjera të parapara me Ligj.

Neni 3

RTK-së, i takon e drejta ekskluzive e shfaqjes televizive të filmit që e bashkëfinancon.

Neni 4

Shfaqja e filmave në RTK do të fillojë pas kalimit të afatit prej 12 muaj nga shfaqja e parë publike e filmit që ka marrë mbështetje nga RTK, kjo mund të bëhet edhe me marrëveshje të veçantë mes produksionit filmik të përkrahur dhe RTK. Shfaqja e filmave do të bëhet sipas kushteve dhe kërkesave të RTK (kushtet dhe kërkesat e RTK duhet të specifikohen).

Neni 5

RTK pajtohet që ta promovojë filmin gjatë fazës së xhirimit në programet e veta kulturore e informative si dhe të transmetojë falas reklamën e filmit për shfaqjen në Kinematë e Kosovës.

Neni 6

Marrëveshja mes QKK dhe RTK nuk përjashton mundësinë që producentët e filmit të bashkëfinancuar të kenë apo të gjejnë bashkëprodhues tjerë, vendor apo të jashtëm, por pa i cenuar të drejtat e rezervuara për QKK dhe RTK.

Neni 7

QKK nuk e obligon Producentin e filmit, që ta pranojë marrëveshjen e QKK dhe RTK, nëse ka siguruar apo zotohet se do ti sigurojë mjetet vetanake.

Neni 8

Për filmat që subvencionon QKK, RTK përveç financimeve me mjete financiare, sipas mundësive që ka, mund ti ofrojë mjetet teknike (duke përfshi kamerën, audio pajisjet, montazhin dhe transportin) dhe stafin përcjellës, si bashkëpjesmarrje në prodhim të filmit, në bazë të nevojave dhe kërkesës së projektit/producentit të filmit, dhe mundësive që ka RTK.

Neni 9

Me kërkesën e producentit/projektit, RTK sipas mundësive që ka, do të vendosë ti japë pajisje shtesë apo hapësirë në studio për nevojat e filmit.

Neni 10

QKK nuk i obligon producentët e filmave të përzgjedhur të pranojnë ofertën teknike-logjistike nga RTK.

Neni 11

RTK dhe produksioni/Producenti i përkrahur lidhin marrëveshje të veçantë për kohën dhe kushtet e shfaqjes së filmit.

Financat

Neni 12

QKK mban të drejtën e caktimit të afateve për transferimin e mjeteve financiare Producentit/Projektit të përzgjedhur, sipas Ligjit për Kinematografi, Statutit dhe Rregulloreve të QKK.

Neni 13

RTK, mjetet të cilat i ndanë për krijimin/prodhimin e filmave do ti alokojë në llogari të QKK-së.

Neni 14

RTK do ta njoftojë QKK-në për buxhetin (vlerën monetare) të cilin do ta ndajë për prodhimin e filmave jo më larg se tre muaj pas miratimi të buxhetit nga Kuvendi i Kosovës.

Neni 15

Përveç në rastet e parapara në Nenin 2 të kësaj Marrëveshje, RTK do të alokojë mjetet e saj në llogari të QKK-së jo më largë se gjashtë muaj nga miratimi i buxhetit të RTK-së.

Mbikëqyrja dhe realizimi

Neni 16

Qendra Kinematografike e Kosovës mban përgjegjësi për:

- për mjetet të cilat i kanë investuar në bashkëprodhimin e filmit.
- QKK do të kujdeset që mjetet të cilat i kanë bashkëfinancuar të shpenzohen në përputhje me legjislacionin e saj dhe ligjeve të aplikueshme në Kosovë
- Producenti duhet të sjellë raportet financiare të detajuara për QKK.
- Në rastet kur RTK investon mjete teknike/ logjistike/ staf, do të përcaktohet vlera monetare e investimeve në mes të palëve dhe në bazë të saj do të përcaktohet përqindja e investimit të RTK-së.

- QKK, obligohet që menjëherë pas lidhjes së kontratave me producentët fitues ta njoftojë RTK-në për projektet që kanë pranuar financimin e RTK dhe se cilat projekte RTK do të ketë të drejtën ti shfaqë sipas pikës I.2.
- Kontrata për bashkëfinancim të projekteve do të nënshkruhet nga QKK dhe Producenti/Produksioni,
- Kjo marrëveshje mund të ndryshohet me pajtimin e palëve. Ndryshimi dhe plotësimi duhet të jetë në formë të shkruar.
- QKK do të fton RTK-në të propozon 2 emra (nga fusha e filmit apo produksionit) që do të futen në listën për anëtarë të Jurisë Vlerësuese për përzgjedhjen e projekteve filmike në Konkursin që shpall QKK-ja, listë kjo që Drejtori i QKK ia paraqet Këshillit drejtues për aprovim.
- Një nga anëtarët e propozuar do të zgjidhet anëtar i jurisë me të drejta dhe detyra të barabarta me anëtarët tjerë të jurisë.
- QKK si dhe të gjitha palët e treta, në asnjë rast nuk kanë të drejtë të përzierjes dhe cenimit të pavarësisë editoriale apo në çfarëdo mënyre të ndikoj në punën e stafit të RTK-së. Në rast të tillë, RTK mbanë të drejtën e shkëputjes së menjëhershme të kësaj marrëveshje.

Neni 17

Kjo Marrëveshje mund të shkëputet me paralajmërim me shkrim nga të dy palët nënshkruese, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në këto raste:

- kur bëhen shkelje esenciale të dispozitave të kësaj kontrate nga ana e cilësdo palë kontraktuese;
- me marrëveshje reciproke të palëve kontraktuese.

Neni 18

Palët obligohen që të lajmërojnë me shkrim njëra tjetrën, sa më shpejtë që është e mundur, përkitazi me shfaqjen e rrethanave të reja, të cilat pamundësojnë përmbushjen e tërësishme apo të pjesërishme të obligimeve dhe përgjegjësive të marra me këtë marrëveshje, për shkak të fuqisë madhore, apo për çdo ndryshim tjetër të rrethanave që do të pengojnë apo kërcënojnë realizimin e kësaj kontrate.

Neni 19
Fuqia Madhore (Vis Major) ka të bëjë me: veprim apo akt mbinatyror, luftë (e deklaruar apo jo), invasion, revolucion, kryengritje, apo akte tjera të natyrës së ngjashme, duke përfshirë edhe ndryshimet ligjore të cilat pamundësojnë zbatimin e kësaj kontrate.

Neni 20
Dispozitat e kësaj marrëveshje, mund të ndryshohen dhe/apo plotësohen përmes aneks marrëveshjes, e cila do të jetë pjesë përbërëse e saj. Të gjitha komunikimet në mes të palëve që kanë të bëjnë me dispozitat e kësaj marrëveshje apo që kanë të bëjnë me ndryshimin e saj, duhet të bëhen në formën me shkrim nga ana e personave nënshkrues të saj, respektivisht personave të autorizuar.

Neni 21

RTK nuk do të:

- mbajë përgjegjësi për zhdëmtimin e palëve të treta për çfarëdo kërkese apo dëmi, që mund të shkaktohet nga implementimi i kësaj marrëveshje dhe që mund t'i adresohet QKK-së;
- pranojë përgjegjësinë për kompenzim me rastin e vdekjes, gjymtimit apo të çfarëdo rreziku tjetër që mund shfaqet gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje.
- jetë përgjegjës për çfarëdo tejkalimi të shpenzimeve të kontraktuara.

Neni 22

QKK do të mbrojë RTK-në nga të gjitha shqetësimet nga palët e treta e që mund të shfaqen në lidhje me realizimin e kësaj Marrëveshje.

Neni 23

Për të gjitha kontestet dhe mosmarrëveshjet eventuale Palët nënshkruese do të i zgjidhin me mirëkuptim të ndërsjellë.

Neni 24

Kjo marrëveshje hyn në fuqi duke filluar prej datës 01. 01.2015 deri më datë 31. 12. 2015, me mundësi të ripërtritjes.

Neni 25

Kjo Marrëveshje është hartuar në 4 (katër) kopje origjinale, ku palët nënshkruese marrin nga 2 (dy) kopje.

Qendra Kinematografike e Kosovës

Drejtori: Arben Zharku

V.V.

Radio-Televizioni i Kosovës

Drejtori i përgjithshëm: Mentor Shala

V.V.